Vendim nr. 317, datë 06.10.2026

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Marsida Xhaferllari,	Kryesuese
Genti Ibrahimi,	Anëtar
Ilir Toska,	Anëtar

në datën 06.10.2026 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 55 (A) 2026 të Regjistrit Themeltar, që i përket:

KËRKUES: **ALTIN HAXHIU**, përfaqësuar nga avokati Kevin Haxhiu, me prokurë.

OBJEKTI: **Shfuqizimi i vendimeve nr. 122, datë 01.04.2025 të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar; nr. 143 (87-2025-210), datë 19.06.2025 të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar; nr. 00-2026-53, datë 27.01.2026 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.**

BAZA LIGJORE: **3, 4, 5, 42, 122, 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pika 1, shkronja "i", të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*KEDNJ*); nenet 22, 27, 49, 50, 71/a dhe 71/b të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar (*Ligji Organik i Gjykatës*).**

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoi relatorin e çështjes Ilir Toska, shqyrtoi kërkesën dhe dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Në datën 17.07.2024 kërkuesi Altin Haxhiu ka paraqitur kallëzim penal në Prokurorinë e Posaçme për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar (*Prokuroria e Posaçme*) ndaj disa shtetasve, përfshirë ish-kryetarin dhe ish-sekretarin e përgjithshëm të Bashkisë Lushnjë në periudhën 1992-1996, për veprat penale "Shpërdorimi i detyrës", "Falsifikimi i dokumenteve", "Korrupsioni aktiv i funksionarëve të lartë shtetërorë ose të zgjedhurve vendorë", "Përfitimi i paligjshëm i interesave", "Refuzimi për deklarim, mosdeklarimi, fshehja ose deklarimi i rremë i pasurive, interesave privatë të personave të zgjedhur dhe nëpunësve publikë ose i çdo personi tjetër që ka detyrimin ligjor për deklarim", "Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike" dhe "Pastrimi i produkteve të veprës penale", të parashikuara përkatësisht nga nenet 248, 186, 245, 257, 257/a, 259 dhe 287 të Kodit Penal (*KP*). Sipas kallëzimit, kërkuesi është trashëgimtar ligjor i të ndjerit B.H., i cili ka pasur pasuri të paluajtshme në qytetin e Lushnjës, që me vendimin e datës 12.12.1994 të Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave (*KKKP*), Bashkia Lushnjë u janë njohur trashëgimtarëve të A.P. dhe janë regjistruar në emër të tyre. Kërkuesi ka pretenduar se për këto veprime mbajnë përgjegjësi ish-kryetari i KKKP-së, i kallëzuari V.Sh., dhe ish-kryetari i Bashkisë Lushnjë, i kallëzuari K.H., të cilët kanë vepruar në bashkëpunim me njëri-tjetrin. Gjithashtu, ai ka pretenduar se këta shtetas, në bashkëpunim me të kallëzuarit P.Sh. dhe S.P., kanë kryer, në formën e grupit të strukturuar kriminal, veprime për pastrimin e produkteve të veprave penale dhe shtimin e paligjshëm të pasurive, ndër të tjera, përmes ndërtimit të një pallati në tokën që i ishte kthyer të kallëzuarit S.P., nga i cili kanë përfituar pasuri.

2. Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme, pasi ka shqyrtuar kallëzimin, me shkresën e datës 19.07.2024, ia ka përcjellë për kompetencë Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier (*Prokuroria e Fierit*). Ai ka vlerësuar se kallëzimi nuk përmbante të dhëna ose indicie që të mbështesnin pretendimin për kryerjen e veprave penale në formën e grupit të strukturuar kriminal, sipas nenit 333/a të KP-së, ose që të evidentonin elemente të veprave penale në kompetencën lëndore të gjykatave të posaçme, sipas nenit 75/a të Kodit të

Procedurës Penale (*KPP*), apo përfshirjen e subjekteve për hetimin e të cilave është kompetente Prokuroria e Posaçme. Gjithashtu, ai ka vlerësuar se nevojiteshin verifikime të mëtejshme për faktet e kallëzuara lidhur me veprimet e ish-kryetarit të KKKP-së, Lushnjë, vendimmarrjen e këtij komisioni dhe pretendimet për pastrimin e produkteve të veprës penale dhe shtimin e paligjshëm të pasurisë.

3. Kërkuesi ka kundërshtuar gjyqësisht shkresën e mësipërme. Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar (*GJKKO-ja e Shkallës së Parë*), me vendimin nr. 471, datë 03.10.2024, ka vendosur mospranimin e ankimit. Mbi ankimin e kërkuesit, Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar (*GJKKO-ja e Apelit*), me vendimin nr. 17 (87-2025-22), datë 22.01.2025, ka ndryshuar vendimin e gjykatës së shkallës së parë, duke konstatuar pavlefshmërinë absolute të aktit procedural të Prokurorisë së Posaçme të datës 19.07.2024, me lëndë "Dërgohet për kompetencë kallëzimi penal", dhe duke urdhëruar këtë prokurori të regjistrojë kallëzimin penal të kërkuesit në regjistrin e njoftimit të veprave penale, sipas nenit 287, pika 1, të KPP-së. Sipas GJKKO-së së Apelit, Prokuroria e Posaçme kishte detyrimin të regjistronte fillimisht kallëzimin penal dhe, pas kryerjes së veprimeve fillestare verifikuese, të vlerësonte ekzistencën e kushteve për fillimin e procedimit penal. Për këtë arsye, ajo nuk ka pranuar kërkimin për detyrimin e Prokurorisë së Posaçme që të regjistronte procedimin penal, duke vlerësuar se një vendimmarrje e tillë nuk mund të merrej pa u regjistruar më parë kallëzimi dhe pa u verifikuar kushtet e procedueshmërisë penale. Në këtë drejtim, ajo gjykatë ka arsyetuar se pas regjistrimit të kallëzimit prokuroria duhej të vendoste, sipas rastit, mosfillimin e procedimit penal brenda afatit ligjor 15-ditor, nëse ekzistonin rrethanat që nuk lejonin fillimin e tij, ose të vijonte me hetimet paraprake. Gjithashtu, ajo ka vlerësuar se nëse gjatë hetimeve paraprake faktet e kallëzuara do të rikualifikoheshin juridikisht dhe për rrjedhojë do të humbiste kompetenca lëndore e posaçme, mund të procedohej sipas nenit 28, pika 1, të KPP-së.

4. Në vijim, Prokuroria e Posaçme i ka kërkuar informacion Prokurorisë së Fierit nëse materiali kallëzues i kërkuesit, i përcjellë me shkresën e datës 19.07.2024, ishte regjistruar dhe, në rast se po, të dhëna për numrin e kallëzimit ose të procedimit penal, veprën penale, personin nën hetim, nëse kishte të tillë, si dhe mënyrën e zgjidhjes së çështjes. Me shkresën e datës 31.01.2025, Prokuroria e Fierit ka informuar se:

4.1. Me shkresën e datës 14.05.2020, Prokuroria e Posaçme i kishte përcjellë prokurorisë kompetente aktet e një kallëzimi penal të mëparshëm të kërkuesit për veprën penale "Falsifikimi i

dokumenteve", të parashikuar nga neni 186 i KP-së, lidhur me pretendimin se anëtarët e ish-KKKP-së, Lushnjë, përfshirë kryetarin e saj, kishin shpërdoruar detyrën në nxjerrjen e vendimit nr. 78, datë 22.08.1995. Me vendimin e datës 01.06.2020, prokurori i çështjes kishte vendosur mosfillimin e procedimit penal, për shkak të parashkrimit të ndjekjes penale dhe amnistisë së vitit 1997. Mbi ankimin e kërkuesit, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lushnjë, me vendimin nr. 81 (1490), datë 27.07.2020, kishte vendosur rrëzimin e tij. Ky vendim ishte ndryshuar nga Gjykata e Apelit Vlorë, me vendimin nr. 320, datë 28.12.2020, e cila kishte urdhëruar regjistrimin e procedimit penal dhe kryerjen e hetimeve për veprën penale të falsifikimit të dokumenteve. Për rrjedhojë, Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë kishte regjistruar procedimin penal nr. 275/2021, për veprën penale të parashikuar nga neni 186 i KP-së, dhe kishte kryer veprimet hetimore të urdhëruara nga gjykata e apelit.

4.2. Kallëzimi penal i kërkuesit, i përcjellë nga Prokuroria e Posaçme në datën 19.07.2024, lidhej me të njëjtat fakte penale për të cilat ishte regjistruar procedimi penal nr. 275. Në kuadër të këtij procedimi ishin administruar dhe trajtuar edhe kallëzime të tjera të kërkuesit, të përcjella për kompetencë nga Prokuroria e Posaçme. Në datën 27.12.2024 prokuroria kishte paraqitur në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier kërkesën për pushimin e procedimit penal, për shqyrtimin e së cilës ende nuk ishte caktuar data e seancës paraprake. Bashkëlidhur informacionit, Prokuroria e Fierit ka dërguar edhe aktet dhe vendimet e marra në kuadër të procedimit penal.

5. Prokuroria e Posaçme, pasi ka administruar aktet e mësipërme dhe ka kryer veprimet verifikuese që ka vlerësuar të nevojshme, ka arritur në përfundimin se nuk evidentoheshin elementet e veprave penale të kallëzuara. Për rrjedhojë, me vendimin e datës 16.02.2025, ka vendosur mosfillimin e procedimit penal për kallëzimin e kërkuesit të datës 17.07.2024, të regjistruar me nr. 23, datë 29.01.2025. Kundër këtij vendimi kërkuesi ka paraqitur ankim në gjykatë.

6. GJKKO-ja e Shkallës së Parë, me vendimin nr. 122, datë 01.04.2025, ka vendosur rrëzimin e ankimit dhe lënien në fuqi të vendimit të Prokurorisë së Posaçme, duke vlerësuar se pretendimet e kërkuesit nuk gjenin mbështetje në ligj dhe në prova. Sipas gjykatës, i kallëzuari K.H. kishte ushtruar detyrën e kryetarit të Bashkisë Lushnjë në periudhën 1992-1996 dhe, për shkak të parashkrimit të ndjekjes penale, sipas nenit 66 të KP-së, nuk mund të vijonte ndjekja penale për veprat e parashikuara nga nenet 186, 248, 259 dhe 257/a të këtij kodi. Në lidhje me

veprën penale të parashikuar nga neni 257/a i KP-së, ajo gjykatë ka vlerësuar, gjithashtu, se kjo dispozitë ishte shtuar me ndryshimet ligjore të vitit 2003 dhe se, në periudhën kur pretendohej të ishin kryer veprimet, ligjvënësi nuk e kishte parashikuar këtë figurë të veprës penale. Për sa u përket pretendimeve për veprime korruptive, gjykata ka arsyetuar se fakti që një vendimmarrje ose veprim i funksionarëve publikë bie ndesh me pritshmëritë e një pale nuk nënkupton, në vetvete, ekzistencën e korrupsionit. Sipas saj, nga përmbajtja e kallëzimit dhe e ankimit nuk rezultonin fakte ose rrethana konkrete që të mbështesnin dyshimin për kryerjen e veprës penale të parashikuar nga neni 259 i KP-së, përtej pretendimeve të kërkuesit lidhur me vendimmarrjen e të kallëzuarve K.H. dhe V.Sh. gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre publike. Gjykata ka vlerësuar se kërkuesi nuk kishte identifikuar rrethana konkrete për kryerjen e veprimeve korruptive të pretenduara dhe se nuk rezultonin prova ose indicie që të mbështesnin pretendimet për kryerjen e veprave penale nga personat e kallëzuar.

7. GJKKO-ja e Shkallës së Parë ka gjetur të pabazuar edhe pretendimin për kryerjen e veprave penale në formën e grupit të strukturuar kriminal, duke vlerësuar se nga veprimet e kryera nga organi i akuzës nuk rezultonin të dhëna ose indicie që të mbështesnin ekzistencën e elementeve të veprave penale të parashikuara nga nenet 333/a, 334 dhe 28, pika 4, të KP-së. Në lidhje me veprën penale "Pastrimi i produkteve të veprës penale", të parashikuar nga neni 287 i KP-së, gjykata ka evidentuar se kallëzimi ishte përcjellë për kompetencë në Prokurorinë e Fierit, e cila, sipas të dhënave të referuara në vendim, kishte kryer veprime hetimore në kuadër të procedimit penal nr. 250/2021 dhe kishte paraqitur kërkesën për pushimin e tij në gjykatën kompetente. Sipas gjykatës, kërkuesi kishte mundësinë t'i parashtronte pretendimet e tij për hetimet e kryera në kuadër të shqyrtimit gjyqësor të kësaj kërkese. Mbi këto argumente, gjykata ka vlerësuar të drejtë përfundimin e Prokurorisë së Posaçme se nuk ekzistonin të dhëna ose indicie konkrete që të mbështesnin fillimin e procedimit penal për veprimtari korruptive ose vepra të tjera penale në kompetencën e saj lëndore. Kundër këtij vendimi kërkuesi ka paraqitur ankim.

8. GJKKO-ja e Apelit, me vendimin nr. 143 (87-2025-210), datë 19.06.2025, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së shkallës së parë, duke i vlerësuar të pabazuara shkaqet e ankimit. Sipas saj, nga faktet e referuara në kallëzimin penal nuk rezultonin të dhëna ose indicie konkrete me vlerë provuese që të mbështesnin fillimin e procedimit penal për veprimtari korruptive ose vepra të tjera penale në kompetencën lëndore të Prokurorisë së Posaçme. Për rrjedhojë, gjykata e apelit ka vlerësuar se ekzistonin kushtet ligjore për mosfillimin e procedimit penal, sipas nenit

290 të KPP-së, duke konfirmuar ligjshmërinë e vendimit të prokurorisë dhe të gjykatës së shkallës së parë. Kundër këtij vendimi kërkuesi ka paraqitur rekurs.

9. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2026-53, datë 27.01.2026, të marrë në dhomën e këshillimit, ka vendosur mospranimin e rekursit, duke vlerësuar se shkaqet e parashtruara nuk përfshiheshin në ato të parashikuara nga neni 432 i KPP-së. Sipas Kolegjit Penal, mbi kallëzimin e mëparshëm të kërkuesit, Prokuroria e Fierit kishte regjistruar procedimin penal nr. 275 të vitit 2020, në kuadër të të cilit ishin trajtuar edhe faktet objekt të kallëzimit në shqyrtim dhe për të cilin, në datën 27.12.2024, ishte paraqitur kërkesa për pushimin e procedimit penal. Kolegji Penal ka vlerësuar se këto fakte ishin hetuar nga organi i akuzës dhe se çështja ndodhej përpara gjyqtarit të seancës paraprake, ku kërkuesi mund të parashtronte pretendimet e tij për hetimin. Sipas tij, kërkuesi nuk mund të kërkonte hetimin e të njëjtave fakte nga Prokuroria e Posaçme, duke i lidhur ato me pretendimin për ekzistencën e një grupi të strukturuar kriminal, me qëllim justifikimin e kompetencës lëndore të saj. Edhe për veprat e tjera penale të kallëzuara, Kolegji Penal ka vlerësuar se gjykatat e faktit kishin arritur drejt në përfundimin për ligjshmërinë e vendimit të mosfillimit të procedimit penal, për sa kohë nuk rezultonin të dhëna ose indicie konkrete që të mbështesnin ekzistencën e veprave penale në kompetencën e Prokurorisë së Posaçme.

10. Në datën 07.07.2026 kërkuesi ka paraqitur ankim kushtetues individual në Gjykatën Kushtetuese (*Gjykata*), sipas objektit të tij. Në lidhje me afatin për shqyrtimin paraprak të çështjes, të përcaktuar në nenin 47, pika 1, të Ligjit Organik të Gjykatës, bazuar në nenet 15, pika 2 dhe 21, pika 1, të Rregullores për Procedurat Gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese, në këtë afat nuk llogaritet periudha e lejes vjetore, sipas nenit 18, pika 1, shkronja “b”, të po këtij ligji.

II

Pretendimet e kërkuesit

11. ***Kërkuesi,*** në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se është cenuar *e drejta për proces të rregullt ligjor,* në drejtim të:

11.1. *Parimit të sigurisë juridike dhe standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor*, pasi vendimet e kundërshtuara bien ndesh me vendimin e formës së prerë nr. 17 (87-2025-22), datë 22.01.2025 të GJKKO-së së Apelit, me të cilin është konstatuar pavlefshmëria absolute e aktit të Prokurorisë së Posaçme për dërgimin për

kompetencë të kallëzimit penal dhe është urdhëruar regjistrimi i tij në atë prokurori. Ky vendim, i cili nuk është kundërshtuar nga palët, nuk mund të zhbëhej nga vendimet e mëvonshme gjyqësore. Po kështu, vendimet e kundërshtuara bien ndesh me praktikën e Gjykatës së Lartë, konkretisht me vendimin nr. 00-2024-1222 (69), datë 12.03.2024 të Kolegjit Penal, në të cilin ishte mbështetur edhe vendimi i mësipërm i gjykatës së apelit. Gjykatat e zakonshme, sikundër Prokuroria e Posaçme, janë mbështetur në aktet e Prokurorisë së Fierit, edhe pse shkresa e datës 19.07.2024 për dërgimin e kallëzimit penal në atë prokurori ishte konstatuar si akt absolutisht i pavlefshëm. Për rrjedhojë, edhe veprimet e kryera nga Prokuroria e Fierit në lidhje me këtë kallëzim ishin të pavlefshme, ndaj gjykatat nuk mund të mbështeteshin në to, por duhej të urdhëronin Prokurorinë e Posaçme të kryente vetë verifikimet përkatëse. Në këtë drejtim, pas regjistrimit të kallëzimit penal, Prokuroria e Posaçme mund të shpallte moskompetencën vetëm nëse, pas verifikimeve, do të konstatonte se faktet e kallëzuara nuk përfshiheshin në kompetencën e saj lëndore. Edhe arsyetimi i gjykatave se pretendimet për veprën penale të parashikuar nga neni 287 i KP-së mund të parashtroheshin përpara Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier binte ndesh me vendimin e formës së prerë të datës 22.01.2025, pasi kompetente për shqyrtimin e fakteve të kallëzuara ishte Prokuroria e Posaçme. Gjithashtu, vendimi i GJKKO-së së Apelit i datës 19.06.2025 është në kundërshtim me vendimin e mëparshëm të së njëjtës gjykatë të datës 22.01.2025, ndonëse të dyja vendimet janë dhënë nga i njëjti trup gjykues, por mbi bazën e vlerësimeve të ndryshme.

11.2. *Së drejtës për një përgjigje efektive nga organi i akuzës*, pasi Prokuroria e Posaçme ka vendosur mosfillimin e procedimit penal pa kryer vetë veprimet e nevojshme verifikuese për faktet e kallëzuara, duke u mjaftuar me kërkimin e informacionit nga Prokuroria e Fierit. Ajo nuk ka marrë në pyetje kërkuesin, si person që ka dijeni për faktet e kallëzuara, as personat e kallëzuar ose shtetas të tjerë që mund të kishin dijeni për këto fakte. Për rrjedhojë, veprimet verifikuese të Prokurorisë së Posaçme kanë qenë të paplota dhe jofektive, në kundërshtim me Kushtetutën, ligjin dhe praktikën gjyqësore, duke penguar zbardhjen e fakteve dhe vënien përpara përgjegjësisë penale

të personave që ai pretendon se kanë kryer veprat penale në formën e grupit të strukturuar kriminal.

11.3. *Parimit të paanshmërisë në gjykim*, pasi gjykatat e zakonshme kanë riprodhuar vlerësimet e Prokurorisë së Posaçme për rrethanat e çështjes, pa marrë parasysh faktet dhe kundërshtimet e argumentuara të kërkuesit, si dhe duke u mbështetur në akte që ishin absolutisht të pavlefshme.

11.4. *Parimit të subsidiaritetit*, pasi Gjykata e Lartë nuk ka përmbushur detyrimin për të kontrolluar respektimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor nga gjykatat më të ulëta. Ajo është mjaftuar me një kontroll formal të vendimmarrjeve të tyre, pa shqyrtuar pretendimet e parashtruara në rekurs për mangësitë e veprimeve verifikuese të organit të akuzës dhe ligjshmërinë e vendimit të mosfillimit të procedimit penal.

III
Vlerësimi i Kolegjit

A. Për kriteret e pranueshmërisë së kërkesës

12. Gjykimi kushtetues mund të vihet në lëvizje vetëm nëse përmbushen kriteret paraprake të pranueshmërisë së kërkesës, të parashikuara nga Kushtetuta dhe Ligji Organik i Gjykatës. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja "f", dhe 134, pikat 1, shkronja "i" dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të Ligjit Organik të Gjykatës, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private ose publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret kumulative të parashikuara nga neni 71/a i Ligjit Organik të Gjykatës, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuara në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

13. Kriteret paraprake të pranueshmërisë së kërkesës janë të natyrës kumulative, ndaj mosplotësimi qoftë edhe i njërit prej tyre mjafton për të penguar kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare dhe e bën të panevojshëm verifikimin e kritereve të tjera. Gjatë shqyrtimit paraprak, Kolegji mund të verifikojë një ose më shumë prej këtyre kritereve, pa qenë i detyruar të

ndjekë një radhë të paracaktuar të analizës. Mbi këtë bazë, në rastin konkret, Kolegji çmon të ndalet në verifikimin e kriterit të legjitimimit *ratione personae* të kërkuesit.

14. Për sa i përket këtij kriteri, Gjykata ka theksuar se, në kuptim të neneve 131, pika 1, shkronja "f", dhe 134, pikat 1, shkronja "i" dhe 2, të Kushtetutës, individi duhet të provojë interesin e tij si në aspektin procedural, ashtu edhe në atë material (*shih vendimet nr. 65, datë 30.11.2023; nr. 44, datë 26.09.2023 të Gjykatës Kushtetuese*). Në rastin konkret kërkuesi ka kundërshtuar vendimet gjyqësore të gjykatave të posaçme që kanë lënë në fuqi vendimin e Prokurorisë së Posaçme për mosfillimin e procedimit penal lidhur me kallëzimin e tij ndaj disa shtetasve, përfshirë ish-kryetarin e Bashkisë Lushnjë dhe ish-sekretarin e përgjithshëm të këtij institucioni, i cili kishte ushtruar edhe detyrën e kryetarit të KKKP-së, Lushnjë. Sipas kërkuesit, të kallëzuarit kanë kryer veprime të kundërligjshme në lidhje me njohjen dhe kthimin personave të tjerë të pasurive të trashëgimlënësit të tij, si dhe, në bashkëpunim me shtetas të tjerë, në formën e grupit të strukturuar kriminal kanë kryer pastrimin e produkteve të veprave penale dhe shtimin e paligjshëm të pasurive. Duke qenë se ka qenë palë në procesin gjyqësor në të cilin janë dhënë vendimet e kundërshtuara, Kolegji vlerëson se kërkuesi e justifikon interesin e tij në aspektin procedural.

15. Për sa i përket aspektit material të këtij kriteri, Gjykata ka pohuar se individi, si subjekt i kushtëzuar, mund të paraqesë ankim kushtetues individual vetëm për çështje që lidhen me interesat e tij të drejtpërdrejtë, duke treguar se në çfarë mënyre është cenuar në të drejtat e tij kushtetuese, pra se është viktimë e një shkeljeje dhe se pasojat e aktit të kundërshtuar janë të drejtpërdrejta dhe reale për të (*shih vendimet nr. 29, datë 16.04.2024; nr. 44, datë 26.09.2023 të Gjykatës Kushtetuese*). Në këtë kuptim, kërkuesi duhet të justifikojë interesin e tij kushtetues, duke treguar se vendimet gjyqësore të kundërshtuara kanë sjellë pasoja vetjake, të drejtpërdrejta dhe reale në të drejtat e tij themelore.

16. Duke iu kthyer çështjes në shqyrtim, Kolegji vëren se kërkuesi, në thelb, ka kundërshtuar mënyrën e ushtrimit të kompetencës së Prokurorisë së Posaçme për ndjekjen penale të personave të kallëzuar prej tij dhe ligjshmërinë e vendimit të saj për mosfillimin e procedimit penal, si dhe mënyrën e zbatimit të vendimit të formës së prerë të GJKKO-së së Apelit të datës 22.01.2025. Me këtë vendim, gjykata e apelit kishte konstatuar pavlefshmërinë absolute të aktit të Prokurorisë së Posaçme për dërgimin e kallëzimit penal në Prokurorinë e Fierit, pa e regjistruar më parë atë dhe pa kryer vlerësimet përkatëse procedurale, duke urdhëruar regjistrimin e kallëzimit penal në Prokurorinë e Posaçme. Megjithatë, pretendimet e kërkuesit për mënyrën e trajtimit të

kallëzimit penal dhe ligjshmërinë e vendimit të mosfillimit të procedimit penal nuk tregojnë, në vetvete, se rezultati i procedimit penal të kërkuar ishte përcaktues për mbrojtjen e një të drejte të tij kushtetuese.

17. Në këtë drejtim, Kolegji vëren se, ndonëse faktet e kallëzuara lidhen me pretendimin për cenimin e së drejtës së pronës private, kërkuesi nuk ka parashtruar argumente konkrete që të tregojnë se rezultati i procedimit penal të kërkuar ishte përcaktues për realizimin e kësaj të drejte ose se vendimet gjyqësore të kundërshtuara kanë penguar mbrojtjen e saj. Edhe pse nga të dhënat e faqes zyrtare të Gjykatës së Lartë rezulton se kërkuesi ka qenë palë në disa procese gjyqësore civile për çështje pronësie, në ankimin kushtetues ai nuk ka identifikuar lidhjen konkrete ndërmjet procedimit penal të kundërshtuar dhe pretendimeve pasurore që synon të mbrojë në rrugën civile. Në veçanti, ai nuk ka argumentuar se mosfillimi i procedimit penal ka ndikuar në përcaktimin ose realizimin e së drejtës së pretenduar të pronës private apo se vendimet e kundërshtuara i kanë penguar mundësinë për të kërkuar mbrojtjen e kësaj të drejte përmes mjeteve juridike në dispozicion. Për rrjedhojë, kërkuesi nuk ka treguar ekzistencën e një lidhjeje të drejtpërdrejtë ndërmjet vendimeve gjyqësore të kundërshtuara dhe cenimit të pretenduar të së drejtës së tij kushtetuese të pronës.

18. Nga ana tjetër, Kolegji thekson se Kushtetuta nuk garanton një të drejtë autonome për të kërkuar ndjekjen ose dënimin penal të personave të tretë. Edhe Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*GJEDNJ*) ka pohuar se një e drejtë e tillë nuk garantohet nga KEDNJ-ja (*shih Renata McKay-Kopecka kundër Polonisë, vendim për pranueshmërinë, nr. 45320/99, datë 19.09.2006*). Në lidhje me zbatueshmërinë në kontekstin e procedurave penale të nenit 6 të KEDNJ-së, në aspektin e tij civil, GJEDNJ-ja ka theksuar se kundërshtimi gjyqësor i vendimit për mosndjekjen penale të një personi tjetër, nuk synon, në vetvete, përcaktimin e "të drejtave dhe detyrimeve civile" dhe kur nuk ndikon as në mundësinë e individit për të ngritur padi për dëmshpërblim ai nuk përfshihet në fushën e zbatimit të kësaj dispozite në aspektin civil të saj. Sipas GJEDNJ-së, zbatueshmëria në kontekstin e procedurave penale të nenit 6 të KEDNJ-së, në aspektin e tij civil, kushtëzohet nga ekzistenca e një të drejte civile materiale (substanciale) të njohur nga e drejta e brendshme, nga njohja, po në të drejtën e brendshme, e së drejtës procedurale të viktimës së një vepre penale për të ngritur padi, me qëllim realizimin e asaj të drejte civile në fazën përkatëse të procedurave penale të saj dhe nga ndjekja e kësaj të drejte nëpërmjet rrugës së përshtatshme procedurale. Gjithashtu, e drejta civile nuk duhet të jetë duke u ndjekur në mënyrë aktive në një

proces paralel përpara një gjykate tjetër, ndërsa procedimi penal duhet të jetë vendimtar për përcaktimin ose realizimin e saj (*shih Fabbri dhe të tjerë kundër San Marinos [DHM], datë 24.09.2024, §§ 88-93*).

19. Në këtë kuptim, interesi i individit për ndjekjen penale të një personi të tretë mund të marrë rëndësi kushtetuese kur lidhet drejtpërdrejt me mbrojtjen e një të drejte të tij themelore dhe kur akti i kundërshtuar ka sjellë pasoja vetjake, të drejtpërdrejta dhe reale në ushtrimin e kësaj të drejte.

20. Për sa më sipër, Kolegji vlerëson se kërkuesi nuk ka arritur të tregojë se vendimet gjyqësore të kundërshtuara kanë sjellë pasoja të drejtpërdrejta dhe reale në të drejtat e tij kushtetuese. Paraqitja e kallëzimit penal dhe kundërshtimi gjyqësor i vendimit të prokurorit për mosfillimin e procedimit penal justifikojnë interesin e tij procedural, por nuk mjaftojnë për të provuar ekzistencën e një interesi kushtetues në aspektin material. Në rrethanat e kësaj çështjeje, kërkuesi nuk ka treguar se procesi i kundërshtuar ishte përcaktues për mbrojtjen e të drejtave të tij pasurore, as që ai pengonte vijimin e proceseve të tjera civile ose ngritjen e një padie civile dhe as se mosfillimi i procedimit penal ka cenuar ndonjë të drejtë tjetër themelore të lidhur drejtpërdrejt me objektin e atij procesi. Për këtë arsye, pretendimet për parregullsi procedurale në shqyrtimin e ankimeve kundër vendimit të prokurorit, përfshirë ato që lidhen me respektimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë, nuk mjaftojnë për të justifikuar interesin material të kërkuesit në gjykimin kushtetues. Për rrjedhojë, Kolegji çmon se kërkuesi nuk legjitimohet *ratione personae*, sipas neneve 131, pika 1, shkronja "f", dhe 134, pikat 1, shkronja "i", dhe 2, të Kushtetutës, pasi nuk ka arritur të justifikojë interesin e tij kushtetues në aspektin material.

21. Në përfundim, Kolegji çmon se ankimi kushtetues individual nuk plotëson kriteret ligjore paraprake për kalimin e tij për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pikat 1 dhe 2, shkronja "b", të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.